



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH SHPK
(Baza ligjore : Neni 705 e vijues i K.Civil)

Ne Fier sot me date **25.07.2018**, para meje Noterit **Kledi Kënaçi**, anetar i dhomes se notereve Vlore, me zyre noteriale ne Fier, Lagjia "15 Tetori", rruga "Kastriot Muço", pallati nr.7, u paraqiten personalisht shtetasit e meposhtem:

Pala shitese:

Luigi Romano, i biri i Giorgio, lindur me 13.11.1962, ne Matino (LE), Itali, dhe banues ne Galipolli, Itali, me shtetesi Italiane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar prej meje noterit me pasaporte Italiane nr.AA1715501.

Antonio Cisternino, i biri i Egidio, lindur me 19.05.1966, ne Nardo (LE), Itali, dhe banues ne Nardo, Itali, me shtetesi Italiane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar prej meje noterit me karte identiteti italiane nr.AS7321086.

Pala Blerese :

Krienko Memo, i biri i Qazo, i lindur me 08.01.1960, lindur dhe banues ne Fier, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit me leternjoftim me Nr. 025549193.

OBJEKTI I KONTRATES

Shitblerja e pjeses takuese prej 56 % (pesedhjete e gjashte perqind) te kuotave te shoqerise tregtare "NUOVA CONF" shpk.

Pala shitese Luigi Romano dhe Antonio Cisternino, jane ortake dhe bashkepronare te 56 (pesedhjete e gjashte perqind) % te kuotave te shoqerise tregtare "NUOVA CONF" shpk, per shumen totale prej **56 000 (pesedhjete e gjashtemije) lekesh.**

Me vendimin nr. 2 dt. 25.07.2018 te asamblese se ortakeve te shoqerise "NUOVA CONF" shpk eshte marre vendimi, per shitjen e 56 % (pesedhjete e gjashte perqind) te kuotave nga ortaket Luigi Romano dhe Antonio Cisternino tek ortaku Krienko Memo.

Pala shitese Luigi Romano dhe Antonio Cisternino deklarojne se pjesen e tyre takuese prej 56 % te kuotave te shoqerise "NUOVA CONF" shpk, do tja shesin **Z.Krienko Memo**, per nje shume prej:

2 kuota X 28 000 leke = 56 000 (pesedhjete e gjashtemije) leke.

Pala blerese Krienko Memo deklararon se eshte dakort qe te bleje 56 % te ketyre kuotave te shoqerise "NUOVA CONF" shpk, per nje shume prej:

2 kuota X 28000 leke = 56 000 (pesedhjete e gjashtemije) leke.

Palet deklarojne se shuma e blerjes prej **56 000 (pesedhjete e gjashtemije) leke**, eshte likujduar teresisht jashte kesaj zyre noterie, gje te cilen e konfirmojne te dyja palet. (Likujdimi eshte bere me leke ne dore, CASH).

KUSHTET E KONTRATES:

- Pala shitesë mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin përkatës të pronësive mbi këto kuota të shoqërisë "NUOVA CONF" shpk.
- Pala shitesë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate heq dorë mbi çdo të drejtë pronësie mbi këto pjesë të kuotave, duke deklaruar se mbi to nuk ka të drejta pronësie dhe të drejta relative asnjë pale e tretë.
- Pala shitesë e garanton palën blerëse se këto kuota objekt kontrate janë plotësisht të lira nga çdo lloj barre pengë, detyrim ndaj të tretëve, ose sekuestrore mbi to.
- Pala shitesë i kalon palës blerëse pronësinë e plotë mbi këto pjesë të kuotave objekt kontrate, me të gjitha tagrat e pronarit të vetëm.

Shenim : Meqenëse z. Luigi Romani dhe z. Antonio Cisternino janë shtetas italianë, kjo kontratë hartohet në prezencë të përkatës së licensuar të gjuhës italiane Znj. Arbana Zarka, e njohur personalisht prej meje noterit, e cila bën përkthimin e kontratës nga gjuha shqipe në gjuhën italiane në prezencë të palës shitesë.

Këto kontratë palet pasi e lexojnë e gjejnë konform vullnetit të tyre të lirë, e miratojnë duke e nënshkruar atë në prezencën time .

Une noterit , pas nënshkrimit të paleve në kontratë, legalizoj për sa më sipër në këto kopje me të njëjtën vlerë origjinale secila.

PALA SHITESË

Luigi Romano

LUIGI ROMANO


Antonio Cisternino

ANTONIO CISTERMINO




Perkthyesë

Arbana Zarka


ARBANA ZARKA
PERKTHIMË
KIFT 8325916072

PALA BLERËSE

Krienko Memo



NOTER

KLEDI KENACI

